



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage


FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturore, Peizazh kulturor**

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR


Manastiri i Deçanit

Fotografi pamje karakteristike, dt.2016









Data/t kryesore të themelimit të asetit
Periudha/t historike (Shek. XIV - XV)

Adresa, Qyteti/Fshati, Komuna Deçan

Lloji i asetit të propozuar
(Kategoria ligjore dhe Nënkatëgoria sipas nenit 2 të LTK)
Sakrale – Manastir

Numri i inventarit (unik) 003106

Numri i regjistrit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/ referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Akti i mëhershëm nëse ka

Data e mbrojtjes: Nën mbrojtje të përhershme
Lloji i mbrojtjes: Nën mbrojtje të përkohshme Data e mbrojtjes:

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Të përshkruhet arsyetimi se përse aseti i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nent 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlerat historike: Manastiri i Deçanit me vjetërsinë dhe origjinalitetin e ruajtur deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore dhe arkitekturore gjatë shek XIV, në Deçan.

Vlerat artistike: Manastiri i Deçanit vlerësohet si një ndër veprat monumentale me vlera historike, kulturore, arkitekturore e artistike të një krijimtari figurativo-aplikative. Krahas arkitekturës, teknikës së ndërtimit, shquan edhe me shumë dekoracione, skulptura, afreska dhe trashëgimi muzeale.

Vlerat shoqërore: Krahas vlerave historike, teknike dhe estetike, Manastiri ka vlerë të rëndësishme në aspektin shoqërorë. Ka qenë dhe është vendtakim i qytetareve të cilët praktikojnë ritualet spirituale dhe fetare.

Vlerat shpirtërore: Është ndërtesë ku aplikohet religjioni fetar ortodoks. Dhe konsiderohet si njëra prej monumenteve me vlera të veçanta në Deçan dhe regjion

Propozuesi:

Institucioni: QRTK-Pejë.....

Emri/ Mbiemri: Shpresa Gjonbalaj

Nënshkrimi

Adresa dhe kontakt informacione: **Rr. Enver Hadri Nr. 75 Pejë**.....

Data : 28/09/2016

Bashkangjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Mbrojtja dhe menaxhimi i asetit/Masat juridike dhe teknike
6. Monitorimi
7. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt.../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Deçan

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit

Deçani është qytet në pjesën perëndimore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Pejës, Gjakovës, dhe me Republikën e Shqipërisë. Është i njohur për rrugët historike në mes Pejës dhe Gjakovës. Shikuar nga ana fetare Deçani është i njohur për Kishën Ortodokse. Territori i kësaj komune mbulon 180 km², dhe ka më se 42 fshatra.

Deçani është vendosur përgjatë rrugës kryesore Pejë-Gjakovë-Prizren, dhe ka pozitë të mirë gjeografike. Nëpërmjet hekurudhës në Pejë lidhet me arterien kryesore ballkanike. Rruga automobilistike nëpër Pejë, Zhleb dhe Rozhajë bënë lidhjen më të shkurtër me Detin Adriatik, ndërsa nëpërmjet Gjakovës dhe Prizrenit lidhet me pjesët jugore të Kosovës dhe me rrugën kombëtare, me Shqipërinë.

Deçani është afirmuar si qendër turistiko-rekreative. Fenomenet natyrore dhe ato të rralla antropogjenë të këtij mjedisi parqesin motivet komplementare turistike të Rrafshit të Dukagjinit. Është me interes dhe atraktive lugina fluvialo g-glaciale e Lumbardhit të Deçanit, e cila prej burimit deri në vendderdhje në Drinin e Bardhë, me gjatësi 40 km, ka një pjerrtësi vertikale rreth 2000 m. E tërë hapësira rreth Deçanit, gjegjësisht në mallet që e rrethojnë, janë me liqene akullnajore due me lugina të lumenjve, të cilat kanë formë të grykës due janë shumë tërheqëse për vizitorë. Pyjet e llojlojshme, kullotat e shumta, fauna e pasur, ajri I freskët due I pastër malor i Alpeve Shqiptare, kanë mundësuar që Deçani të afirmohet si qendër rekreativo-turistike. Valorizimi turistik i Deçanit ka fituar renomenë e vet me ndërtimin e pushimorës rrëzë malit të rrethuar me pyje të pishave due të gështenjës. Në afërsi të pushimores gjendet gryka eLumbardhit të Deçanit. Në të dalë të Lumbardhit prej grykës së vet është ndërtuar Manastiri i Deçanit. Kisha due manastiri nuk është i njohir vetëm për arkitekturën, lartësinë, dekorimin plastic të syilit romak në gurë me portalet rreth dritareve, por edhe pse është vendosur në një vend pitoresk.

Në afërsi të Manastirit, në lokalitetin Lloqan, është ruajtur një shtëpi e vjetër e drurit, e cila konsiderohet se është ndërtuar 200-3000 vjet më herët se Manastiri i Deçanit. Atraktiviteti turistik, vendodhja përgjat rrugës së rëndësishme, trendet e zhvillimit ekonomik të Deçanit kanë ndikuar që me rastin e reorganizimit administrative në vitin 1960 të bëhet qendër komunale. Deri vonë Deçani ka pasur fizionominë e e fshatit, ndërtesa të ulëta të tipit të grumbulluar due kulla e Dukagjinit I japin disa elemente të arkitekturës rurale. Ndërtimi intenziv i objekteve hoteliere, qendrës shkollore, godinave të tjera për funksionimin e dministratës due të ndërtesve për banim, kanë ndryshuar pamjeen e Deçanit. Përgjat rrugës kryesore Pejë-Gjakovë-Prizren është ndërtuar pjesa e re e Deçanit.

Deçani për këto vite të ekzistimit jo vetëm që ka ndryshuara pamjen por edhe numri i popullsisë është gjithnjë e më i madh. Deçani në vitin 1953 ka pasur 1.339 banor, në vitin 1981 3283, ndërsa statistikat e vitit 2012 tregojnë një numër rreth 66000 banorë.

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituada

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Manastiri gjendet ne Deçan

Perimetri i asetit të propozuar: _____ ha

Zona rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: _____ ha

Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zones rrethuese $P=1:500$ dhe $1:200$.
- Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.
- Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës., orientimi, projeksioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratografinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

Manastiri i Deçanit

Kompleksi Monumental i Manastirit të Deçanit, përkatësisht Kisha e Zonjës është vepër e viteve 1330-1336 e ndërtuar mu nën shpatijet e Bjeshkëve të Nëmura (Alpeve Shqiptare).

Është ndër veprat më me rëndësi të monumenteve të periudhës mesjetare Nemanjide në Kosovë. Ky monument paraqet një vepër të periudhës dhe stilit bizantino-arbëror-kosovar. Në fakt kompleksi është realizim eklektik (sintezë) ku gërshetohen elementet e stilit bizantin romano-gotik kosovar, si në pikëpamje arkitekturale e skulpturale, po ashtu edhe pikturale

Lidhur me themelimin e Manastirit të Deçanit ekzistojnë dokumente të shumta, ku datat nuk janë në pajtueshmëri të plotë. Mirëpo fakti më i saktë është mbishkrimi mbi arkitraun e portikut jugor, në narteksin (hajatin) e kishës.

Mirëpo bazuar në mbishkrimin ekzistues i cili është i gravuar në pjesën e cekur të ndërtimit, kjo kishë është realizuar në vitin 1327-1335.

Manastiri është vepër monumentale e realizuar nën ndikimin e ndërtimtarisë së bregdetit jugor, të qytetit të Kotorrit, Raguzës, Shkodrës, Tivarit e Ulqinit, por në aspektin struktural të ndërtimit plotësisht i përgjigjet natyrës dhe ambientit.

Vepra është realizuar nga arkitekti e ndërtimtari, skulptori e kryemjeshtri shqiptar fra Vita Cuci-Kuqi nga Kotorri.

Manastiri është ndërtim monumental, bazilikë me pesë anijata, e mbuluar me kube, e cila qëndron mbi tambur dhe narteksin me tri anijata.

Në kishë janë të ndërtuara edhe dy altarë të veçantë. Njëri në pjesën veriore të Kishës së Shën Dhimitrit, ndërsa tjetri në anën jugore të Kishës së Shën Nikollës.

Kjo mënyrë e ndërtimit nuk është karakteristike për arkitekturën e Kishave të ritit ortodoks në Kosovë dhe më gjërë. Manastiri ishte në shërbim dhe u shfrytëzua nga popullata krishtere vendore. Në këtë kohë popullsia e rajonit ishte e krishterë.

Kompleksi paraqet tërësi të dekoracioneve plastike skulpturale, e cila është në ndikimin e puntorëve të bregdetit jugor, që arriti këtu në shek XIV, dhe që u realizua nga Kryemjeshti Fra Vita me ndihmën e mjeshtërve vendor. Dekorimet skulpturore përbëjnë pasurinë dhe bukurinë më të madhe të kësaj vepre.

Portalet, dritaret dhe konzolet-ancakët e kurorës së kulmit, janë realizuar me dekoracione të mermerit të përpunuara, të gdhendur.

Bazilika ka katër portale. Ndërsa nga dritaret ka tri trifore, njëzet e një before, dhe dhjetë hapje monofore. Dritaret janë me tegele dhe arkivolta me dekoracione të skalitura në gur. Poashtu janë të realizuara edhe elemente në brendësi të bazilikës, sikurse edhe kapitalet e shtyllave në përgatitoren dhe kishën e objektit.

Njëjtë është e realizuar edhe ikonostasi I ndërtimit në fjalë.

Bazilika ishte e mbuluar me afreska. Të gjitha muret e enterierit të kishës ishin të pikturuara me kompozicione të shumta figurative.

Këto kompozicione janë të ruajtura dhe në gjendje të mirë, dhe sit ë tilla rrisin vlerën e monumentit. Në pikturat murale prezantohen rreth 10000 figura të pikturuara.

Po ashtu Manastiri ka edhe vlera të mëdha muzeale, pra thesar të pasur të eksponateve të lëvizshme.

Në këto koleksione duhet veçuar ikonat, librat në dorëshkrim, si dhe lëndët e ndryshme të karakterit të përdorimit në ceremonitë liturgjike.

Vlen të veçohet se në Manastir gjendet edhe një llambadar, realizuar në stilin e renesancës gjermane, dhuratë nga Gjergj Kastrioti-Skenderbeu në shek. XV. Kjo dëshmon për rëndësinë e Kishës për besimtarët e Krishterë.

Kjo kishë si një pikëpamje arkitekturale, skulpturale e pikturale tregon për ndikime të ndryshme perëndimore në veçanti, ku në masë të madhe janë modifikuar me traditën lokale.

Tani Manastiri është nën përkujdesjen e Uneskos

Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

**Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës
Rëndësia/vlera/t**

Funksioni aktual: Manastiri i Deçanit si kompleks kulturi i besimit ortodoks ka funksionin e ndërtesave ku praktikohen rituale fetare.

Autoritetet përgjegjëse janë: UNESCO, Ministria e Kulturës, Sportit dhe Rinisë (MKRS); Kisha ortodokse dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi dhe Kulturë në Pejë.

Pronësia: Kisha ortodokse në Deçan

Shfrytëzimi aktual: është në shfrytëzim të sërbeve ortodoks të Kosovës

Kategoria e rëndësisë

Sakrale

- Lokale, nacionale, ndërkombëtare.
Lokale

Zhvillimi historik i asetit

Manastiri i Deçanit

Kompleksi Monumental i Manastirit të Deçanit, përkatësisht Kisha e Zonjës është vepër e viteve 1330-1336 e ndërtuar mu nën shpatijet e Bjeshkëve të Nëmura (Alpeve Shqiptare).

Është ndër veprat më me rëndësi të monumenteve të periudhës mesjetare Nemanjide në Kosovë. Ky monument paraqet një vepër të periudhës dhe stilit bizantino-arbëror-kosovar. Në fakt kompleksi është realizim eklektik (sintezë) ku gërshetohen elementet e stilit bizantin romano-gotik kosovar, si në pikëpamje arkitekturale e skulpturale, po ashtu edhe piktorale

Lidhur me themelimin e Manastirit të Deçanit ekzistojnë dokumente të shumta, ku datat nuk janë në pajtueshmëri të plotë. Mirëpo fakti më i saktë është mbishkrimi mbi arkitraun e portikut jugor, në narteksin (hajatin) e kishës.

Mirëpo bazuar në mbishkrimin ekzistues i cili është i gravuar në pjesën e cekur të ndërtimit, kjo kishë është realizuar në vitin 1327-1335.

Manastiri është vepër monumentale e realizuar nën ndikimin e ndërtimtarisë së bregdetit jugor, të qytetit të Kotorrit, Raguzës, Shkodrës, Tivarit e Ulqinit, por në aspektin struktural të ndërtimit plotësisht i përgjigjet natyrës dhe ambientit.

Vepra është realizuar nga arkitekti e ndërtimtari, skulptori e kryemjeshtri shqiptar fra Vita Cuci-Kuqi nga Kotorri.

Manastiri është ndërtim monumental, bazilikë me pesë anijata, e mbuluar me kube, e cila qëndron mbi tambur dhe narteksin me tri anijata.

Në kishë janë të ndërtuara edhe dy altarë të veçantë. Njëri në pjesën veriore të Kishës së Shën Dhimitrit, ndërsa tjetri në anën jugore të Kishës së Shën Nikollës.

Kjo mënyrë e ndërtimit nuk është karakteristike për arkitekturën e Kishave të ritit ortodoks në Kosovë dhe më gjërë. Manastiri ishte në shërbim dhe u shfrytëzua nga popullata krishtere vendore. Në këtë kohë popullsia e rajonit ishte e krishterë.

Kompleksi paraqet tërësi të dekoracioneve plastike skulpturale, e cila është në ndikimin e punëtorëve të bregdetit jugor, që arriti këtu në shek XIV, dhe që u realizua nga Kryemjeshti Fra Vita me ndihmën e mjeshtërve vendor. Dekorimet skulpturore përbëjnë pasurinë dhe bukurinë më të madhe të kësaj vepre.

Po ashtu Manastiri ka edhe vlera të mëdha dekorative, skulpturale, pikturale, muzeale dhe thesare të pasura të ekspozitave të lëvizshme.

Vlen të veçohet se në Manastir gjendet edhe një llambadar, realizuar në stilin e renesancës gjermane, dhuratë nga Gjergj Kastrioti-Skenderbeu në shek. XV. Kjo dëshmon për rëndësinë e Kishës për besimtarët e Krishterë.

Kjo kishë si një pikëpamje arkitekturore, skulpturore e pikturale tregon për ndikime të ndryshme perëndimore në veçanti, ku në masë të madhe janë modifikuar me traditën lokale.

Tani Manastiri është nën përkujdesjen e Uneskos, si dhe në listë nën mbrojtje të përkohshme të MKRS-së.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- Manastiri i Deçanit është ndërtim unik në Kosovë.
Kemi të bëjmë me një kishë që ka një arkitekturë sipas modelit të Dalmacisë ambientuar me karakteristikat vendore.
Kryemjeshtri i Manastirit ishte arkitekti nga Kotori (Fra Vitta Cucci), i cili realizimin e bëri në bashkëpunim me mjeshtër vendor.
Ndërtimi i Manastirit është bërë me blloqe nga guri me ngjyra të ndryshme.
Monumenti i takon periudhës ndërmjet vitit 1327-1335.
Vlerat e saj arkitekturore e estetiko artistike janë të padiskutueshme, për këtë arsye në vitin 2006 është futur nën mbrojtje të UNESCO-s.
- Në aspektin komparativ themi se nuk kemi ndërtim analog në Kosovë, ndaj autenticiteti ja shton vlerën edhe më shumë këtij monumenti.
- Në aspektin e ruajtjes së autenticitetit kemi të bëjmë me një ekzemplar mjaft të ruajtur dhe me integritet të pa cenuar, pasi që mbrohet nga rrethoja e gurit së cilës i është shtuar edhe një rrethojë shtesë, gjë që e ka bërë kompleksin shumë të izoluar dhe vështirë të dukshëm nga jashtë.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- Gjendja teknike e asetit pas restaurimit është relativisht e mirë, pasi që është ruajtur autenticiteti dhe integriteti.
- Ndikimi i rrethinës është mjaft i vogël në aspektin e mjedisit për shkak se në afërsi nuk kemi objekte tjera pos konakut i cili është restauruar pas luftës nga InterSOS-i.

- MBROJTJA DHE MENAXHIMI I ASETIT/POLITIKA, MASAT JURIDIKE DHE TEKNIKE

- *Programet/Planet e promovimit, interpretimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së autenticitetit/integritetit të asetit, duke specifikuar nevojën dhe planet për ndërhyrje hulumtuese, riparimi urgjent, restaurimet dhe adaptimet për përdorim bashkëkohorë.*
- *Përdorimi i ndërtesës dhe shfrytëzuesit/pronari*
- *Statusi i asetit në relacion me legjislacionin për planet e zhvillimit territorial dhe programet tjera zhvillimore.*
- *Relacioni i mbrojtjes së asetit me Planet ekzistuese zhvillimore të qytetit, fshatit, Komunës dhe Planin Hapsinorë të Kosovës.*
- *Sistemi i menaxhimi të asetit*
- *Resurset financiare vjetore në dispozicion apo të nevojëshme*
- *Resurset profesionale në dispozicion dhe nevojat*
- *Kushtet për vizitor dhe statistikën*

Shtojcë4: Projekt propozimet për punë hulumtuese dhe teknike, dhe Plani i menaxhimit të asetit

5. MONITORIMI/INSPEKTIMI

Monitorimi dhe inspektimi i asetit nuk mund të bëhet nga Institucionet vendore. Ngase Manastiri nuk lejoj që QRTK-Pejë të bëjë inçizin dhe monitorimin e tij, sikur ndodh me monumentet tjera në rajonin e Pejës.

Ndaj edhe raportimi dhe qasja është thuaja e pamundur, ngase autoritetet kishtarë që menagjojnë monumentin, nuk lejojnë qasje për institucionet vendore.

6. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi, slajda dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershme mbi statusin ligjor të asetit.*
- *Shtojcë 1, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Shtojca 2, Planet e situacionit të asetit me shenjzime të kufirit perimetral dhe zones rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe digjitale.*

- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelt, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.*
- ***Shtojcë 3:*** *Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*
- ***Shtojcë4:*** *Projekt propozimet për punë hulumtuese apo ndërhyrje teknike dhe Plani i menaxhimit të asetit të propozuar për mbrojtje.*

7. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni ...QRTK – Pejë

Hartuesit e formularit: Shpresa Gjonbalaj- Drejtor i QRTK-Pejë
 Arsim Mulhaxha- Ark.

Adresa **Rr. Enver Hadri Nr. 75**.....

Konakt Tel/Faks/email,ëeb faqe

..039 434 147.....

Data *22/09/2016*

Nënshkrimi